



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 1402 prot.

Shkodër, më 13.04. 2022

V E N D I M

Nr. 93, datë 13. 04. 2022

"Për miratimin e Strategjisë sektoriale të tregut të punës në USH"

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Ncni 38, pika 1, germa b; Statutin e USH-së Ncni 17, pika 6, germa b, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 13.04.2022

Vendosi:

1. Të miratojë "Strategji sektoriale e tregut të punës (bashkëlidhur).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Strategjia Sektoriale e Tregut të Punës - Universiteti i Shkodrës



**UNIVERSITETI I SHKODRËS
“LUIGJ GURAKUQI”**

Strategjia e Tregut të Punës

1 Hyrje

Ky dokument ka synimin të orientojë politikat dhe vendimet e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" që lidhen me nxitjen, ndërmjetësimin, mbështetjen dhe hyrjen e të rinjve të diplomuar në gjitha ciklet studimore të USH-së për periudhën 2021-2025 në tregun e punës. Ky dokument është hartuar nga një grup pedagogësh, ekspertë të fushës, me bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e drejtuesve të USH-së, Fakulteteve dhe Instituteve Kërkimore.

Tregu i punës është një përbërës i rëndësishëm i çdo ekonomie dhe i referohet ofertës dhe kërkësës për punë, ku punonjësit sigurojnë ofertën e punës dhe punëdhënësit sigurojnë kërkësen për punë.

Tregu i punës shikohet në të dy nivelet: makroekonomike dhe mikroekonomike.

Në nivelin makroekonomik, oferta dhe kërkesa ndikohen nga dinamikat e tregut vendas dhe ndërkombëtar, si dhe faktorë të tillë, si: emigracioni, mosha e popullsisë, niveli i arsimit etj. Matës të rëndësishëm të tregut të punës në nivelin makroekonomik përfshijnë normën e papunësisë, normat e pjesëmarrjes në punë, produktivitetin, të ardhurat totale dhe produktin e brendshëm bruto.

Në nivelin mikroekonomik, firmat individuale bashkëveprojnë me punonjësit, duke i punësuar apo larguar nga puna ata, duke rritur apo ulur pagat dhe orët e punës. Marrëdhënia midis ofertës dhe kërkësës ndikon në orët e punës së punonjësve dhe kompensimin që ata marrin nëpërmjet pagave dhe përfitimeve. Pagat individuale dhe numri i orëve të punës janë dy matës të rëndësishëm mikroekonomikë.

Studentët e diplomuar në të tre ciklet e studimit të nivelit universitar përbëjnë një komponent të rëndësishëm të tregut të punës. Gjatë periudhës 2017-2020 shkalla zyrtare e papunësisë është luhatur në shifrat 15-12% dhe për të rinjtë shkalla e zyrtare e papunësisë ka qenë shumë më e lartë, pasi luhatet në shifrat 25%, tregues ky i vështirësive që hasin të rinjtë në gjetjen e një vendi pune të qëndrueshëm. Sipas të dhënavë të INSTAT, duke analizuar shkallën e papunësisë, sipas nivelit arsimor gjatë vitit 2019, rrëth 14,4 % e të rinjve me arsim të mesëm janë të papunë, ndërsa 12,3% e të rinjve me arsim të lartë e vuajnë këtë fenomen. Kalimi nga bankat e universitetit në jetën profesionale është një moment kyç për çdo student universitar, i cili përballet me vështirësitet e njohjes dhe orientimit në lidhje mbi mundësitetë dhe orientimin që do të marrë jeta e tij profesionale. Hyrja në jetën profesionale përbën një fazë kritike gjatë së cilës shumë aktorë të ndryshëm kontribuojnë për orientimin e studentit të sapodiplomuar në vendin e punës, si: njohjet personale, rrëthi shoqëror, familja, institucionet publike, si zyrat e punës, universiteti. Punësimi është një sfidë për çdo student të sapodiplomuar dhe mbajtja e tyre të informuar periodikisht mbi mundësitetë që ofrohen në tregun e punës i orienton studentët të reflektojnë mbi atë çfarë ata duan dhe rrugët që duhet të ndjekin. Studimi dhe orientimi në tregun e punës u mundëson atyre identifikimin e kapaciteteve, kompetencave dhe interesave për të marrë vendime arsimimi, aftësimin profesional për të menaxhuar rrugët e jetës individuale në punë dhe fusha të tjera të ngjashme në të cilat mësohen dhe përdoren këto kapacitete dhe kompetenca. Është pikërisht universiteti që shërben si një urë lidhëse e studentit me tregun e



organizimin e eventeve të veçanta, si: Panairi i Punës, Ditët e Karrierës, seminare, takime informuese, të cilat synojnë pikëtakimin ndërmjet kërkesës dhe ofertës;

- monitorimin e punësimit të të diplomuarve.

3 Analizë e faktorëve të jashtëm

Faktorët politiko-ligjorë

Forca politike që fitoi zgjedhjet e përgjithshme më 25 prill 2021 me rreth 48.7% të votave mori një mandat të tretë. Opozita që bojkotoi zgjedhjet lokale të vitit 2019, përmirësoi ndjeshëm rezultatet e saj - brenda një koalicioni të gjerë prej 13 partish - duke siguruar gati 40% të votave. Komuniteti ndërkombëtar, përfshirë BE-në, mbështeti zgjedhjet.

Fitorja e mandatit të tretë nga forca politike qeverisëse dhe rezultatet e mira të opozitës janë pozitive për stabilitetin politik dhe demokracinë. Premisat janë që do të garantohet vazhdimësia e politikave aktuale dhe të rriten investimet e huaja në infrastrukturë (turizëm, energji dhe transport). Zhvillimet politike të vitit 2021 mund të kenë një ndikim pozitiv në fillimin e negociatave të pranimit në BE (miratuar në pranverën e vitit 2020) që mund të ndodhin deri në fund të vitit 2022.

Faktorët demografikë, socialë, kulturorë

Popullsia e Shqipërisë më 1 janar 2021 rezulton 2.829.741 banorë, duke pësuar një rënie me 0,6%, krahasuar më 1 janar 2020. Ndërsa, më 1 janar 2021, mosha mediane e popullsisë rezulton 37,6 vjeç nga 37,2 vjeç që ishte më 1 janar 2020. Shqipëria numeron 661,365 të rinj dhe të reja të grupmoshës 15-29 vjeç përgjatë vitit 2019-2020, duke përfaqësuar kështu një të tretën (23,2%) e të gjithë popullsisë. Popullsia e të rinjve dhe të rejave në Shqipëri po ndjek një trajktore gjithnjë e në ulje, duke e krahasuar me vitin 2014 popullsia e të rinjve në vitin 2020 është ulur me mbi 69.531 banorë. Sipas Zyrës Evropiane të Mbështetjes së Azilantëve – EASO, bazuar në statistikat e azilkërkuesve shqiptarë në vendet evropiane, çdo vit aplikojnë rreth 19.200 shtetas shqiptarë. Më 1 janar 2021 qarku Shkodër ka një popullsi prej 197.177 banorësh.

Strategja Sektoriale e Tregut të Punës - Universiteti i Shkodrës



te vitit. Sipas Instat në vitin 2020 në Shkodër u mbyllën 214 biznese, numri më i madh në rang vendi.

Turizmi dhe udhëtimet ka të ngjarë të mbeten të kufizuara derisa të përfundojë vaksinimi global. Prodhimi i Brendshëm Bruto parashikohet të rritet me 4.4 përqind në 2021, 3.8% në 2022, 3.7% në 2023, ndërsa eksportet, konsumi dhe investimet do të rriten pjesërisht. Sektori i shërbimeve, i udhëhequr nga turizmi dhe ndërtimi, priten të jetë faktorët kryesorë të rimëkëmbjes pjesërisht, falë investimeve në rindërtim pas sprovave të periudhës 2019-2020. Investimet private do të kontribuojnë në rritjen ekonomike nëse qeveria do të vazhdojë të zbatojë reformat e klimës së biznesit. Në një periudhë afatshkurtër, shpenzimet qeveritare ka të ngjarë të kufizohen nga hapësira e kufizuar fiskale. Me rritjen e aktivitetit ekonomik, të ardhurat parashikohen të rriten në 27.6 përqind të PBB-së deri në 2022-25. (World Bank, 2021).

4 Analizë e faktorëve të brendshëm

Universiteti i Shkodrës me 6 fakultetet në përbërje të tij ofron një sërë programesh studimi në nivel bachelor dhe master i shkencave e profesional. Fushat kryesore në të cilat synojnë të punësohen pjesa më e madhe e të diplomuarve nga ky universitet janë si më poshtë:

ARSIMI

Arsimi (publik dhe privat) është një prej sektorëve ku punësohen dhe synojnë të punësohen një pjesë e madhe e të diplomuarve të Universitetit të Shkodrës duke pasur parasysh që një pjesë e mirë e programeve të studimit që ofron ky universitet synojnë përgatitjen e mësuesve për arsimin parauniversitar në shkencat e natyrës, shkencat shoqërore, shkencat e edukimit dhe gjuhët e huaja.

Të diplomuarit në këto fusha kryesisht gjejnë treg pune në mësimdhënie (arsim publik dhe privat parauniversitar), punonjës në administratën publike dhe institucione të shumta private.

SEKTORI SOCIAL

Vitet e fundit edhe në Shqipëri është rritur rëndësia e rolit të sektorit social. Edhe Universiteti i Shkodrës ofron programe studimi në nivel Bachelor dhe Master në fushën e shkencave sociale. Të diplomuarit e Universitetit të Shkodrës në këtë fushë punojnë si psikologë dhe punonjës socialë në institucione të tilla, si: spitalet, jetimoret, azilet, polici, burgje, qendra rehabilitimi, gjykata, ushtri, çerdhe, kopshte, shkolla, në konsultore e klinika si dhe organizata të ndryshme të shërbimeve sociale.

EKONOMIA

Natyrisht, sektori i ekonomisë përfaqëson një tjetër përthithës të rëndësishëm të produktit të Universitetit të Shkodrës, specifikisht të studentëve të diplomuar në Fakultetin Ekonomik. Studentët që diplomohen në secilin prej këtyre programeve i gjen sot të punësuar në të gjitha

Strategjia Sektoriale e Tregut të Punës - Universiteti i Shkodrës

Fakulteti Ekonomik

- Bachelor në Administrim - Biznesi
- Bachelor në Financë- Kontabilitet
- Bachelor në Turizëm

Fakulteti i Shkencave Shoqërore

- Bachelor në Gjuhë - Letërsi
- Bachelor në Histori - Gjeografi me drejtim Histori
- Bachelor në Histori - Gjeografi me drejtim Gjeografi
- Bachelor në Gazetari Komunikim

Fakulteti i Drejtësisë

- Bachelor në Drejtësi

Cikli i dytë Master Shkencor, 2019-2022

Fakulteti i Shkencave të Natyrës

- Master i Shkencave në Biologji Mjedisore

Fakulteti i Shkencave të Edukimit

- Master i Shkencave në Psikologji Organizative
- Master i Shkencave në Mësuesi në Bio-Kimi, profil minor në "Karriera për jetën"
- Master i Shkencave në Psikologji Klinike

Fakulteti Ekonomik

- Master i Shkencave në Administrim - Biznes
- Master i Shkencave në Kontabilitet
- Master i Shkencave në Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm
- Master i Shkencave në Financë

Fakulteti i Shkencave Shoqërore

- Master i Shkencave Studime Regionale në Gjeografi

Fakulteti i Drejtësisë

- E Drejtë Kushtetuese dhe Administrative
- E Drejta Private dhe e Biznesit

Strategjia Sektoriale e Tregut të Punës - Universiteti i Shkodrës

Një moment i veçantë në fazën e kërkimit të punës është takimi ndërmjet studentëve të diplomuar dhe punëdhënësve. Shpesh këto dy palë kanë vështirësi në takimin e tyre dhe universiteti mund të luajë rolin e ndërmjetësit për lehtësimin e këtij kontakti. Lidhur me format e ndryshme të rekrutimit, zyrat e këshillimit dhe karrierës mund të luajnë një rol të rëndësishëm, duke vënë në dispozicion të punëdhënësve në kërkim të personelit kandidatura të mundshme të studentëve të diplomuar.

Universiteti mund të luajë rol të rëndësishëm në vendosjen e një pike kontakti mes të diplomuarve dhe punëdhënësve. Për të garantuar besueshmërinë dhe paanshmërinë e tij, Universiteti duhet të udhëhiqet nga dy parime: *neutraliteti* dhe *transparencë*. Përsa i përket transparencës, universiteti mund të ndërtojë një database e cila duhet të përbajë të dhënat e studentëve të diplomuar. Çdo student mund të regjistrohet dhe të menaxhojë profilin e tij profesional nëpërmjet një llogarie personale.

Faqja personale e studentit, në formën e një CV-je ka:

- të dhënat personale;
- programin e studimit të zgjedhur;
- rezultatet e karrierës së tij universitare, si: notat, titull diplome, (*Kjo pjesë mund të jetë opSIONALE* dhe *studenti mund të vendosë ta shfaqë apo jo. Notat mund të kalohen direkt në faqe nga sistemi i universitetit për të qenë korrekt me vërtetësinë e tyre.*);
- eksperiencia pune;
- certifikata: gjuhë e huaj, kurse profesionale etj.;
- fushat e interesit profesional (p.sh. kontabilitet, marketing, manazhim, mësuesi, administrative etj.);

Bizneset apo punëdhënësit e interesuar mund të kontaktojnë në dy mënyra:

1. Të kenë akses në bazën e të dhënavë të kurrikulave të studentëve. Në këtë rast baza e të dhënavë e kurrikulave mund të ketë filtri sipas profilit të fushës akademike të studentit, p.sh., Fakulteti Juridik, Ekonomik, dega Infermieri etj., në mënyrë që kërkimi të jetë më i lehtë.

Bizneset apo punëdhënësit, pasi të bëhet një verifikim i tyre, mund të bëjnë lajmërimë publike për vende pune sipas një strukture, pak a shumë formale, ku ata tregojnë të dhënat e tyre, profilin e kërkuar, vendndodhjen, kontaktin etj. Lajmërimet e shpallura mund të klasifikohen në bazë të profilit, renditjes kronologjike etj.

Parimi i neutralitetit të universitetit ndaj palëve garantohet duke mos promovuar në veçanti asnje student, pra të mos bëjë një shoshitje të kandidaturave për një vend pune të publikuar nga punëdhënësit, por thjesht të luajë një rol ndërmjetësi duke vendosur në dispozicion të tij kandidatët e profilit të caktuar.

Bashkëpunimi me sektorin privat, institucionet publike me synim nxitjen e punësimit.

Nxitja e punësimit të të diplomuarve kalon nëpërmjet krijimit të urave të bashkëpunimit Universitet – Punëdhënës dhe nëpërmjet përshtatjes së programeve të studimit sipas nevojave të tregut të punës.

Strategjia Sektoriale e Tregut të Punës - Universiteti i Shkodrës

padisitueshëm për zhvillimin e bizneseve turistike dhe si rrjedhojë rritjen e nevojës për të punësuar në këtë sektor.

Programet e studimit të shkencave mjekësore teknike kanë një fushë të gjerë punësimi. Të diplomuarit në programet e studimit bachelor në Infermieri, Mami dhe Fizioterapi, gjjejnë mundësi punësimi në Spitalet Rajonale të veriut në përgjithësi, por jo vetëm, në Drejtori të Shëndetit Parësor të veriut në përgjithësi, në qendra shëndetësore publike dhe private, shkolla, laboratorë dhe institucione të tjera. Shumë studentë të diplomuar në programin e studimit bachelor në Fizioterapi kanë marrë iniciativa private duke hapur klinikat e tyre. Gjithashtu, nuk duhet lënë pa u përmendur fakti, që shumë nga studentët e diplomuar, sidomos në degën e Infermierisë, janë të punësuar jashtë vendit, ku trendi i fundit është Gjermania, por jo vetëm, pasi ka shumë të punësuar në: Itali, Turqi, Amerikë, Suedi, Norvegji etj. Çdo vit përfundojnë studimet studentë të trevave Shqiptare në Malin e Zi, që rezultojnë të gjithë të punësuar në këtë vend.

Për programin e studimit në Informatikë, të diplomuarit kanë një fushë të gjerë punësimi.

Pas diplomimit të tyre, studentët me specializime të mëtejshme në fusha të ndryshme, mund të aplikojnë për një vend pune në sektorët më të kërkuar në industrinë e komunikacionit dhe në kompani të mëdha që ofrojnë zgjidhje IT. Ata mund të punësohen në: krijim dhe zhvillim aplikacionesh, në kompanitë që zhvillojnë sisteme softwarë të gjerë, mësimdhënie, duke mbuluar orët e lëndës së informatikës, në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme, tregun e sistemeve të informacionit si planifikues dhe administrim i sistemit të IT-së, konsulencë në çështje teknike dhe organizative, specialistë dhe manaxhues në departamente të IT-së të institucioneve publike, zhvillues soft-esh në banka të nivelit të parë dhe të dytë etj.

2. Vizioni / Skenari i Mundshëm

Zhvillimi ekonomik i vendit, i shoqëruar me rritjen e investimeve të brendshme dhe të huaja, me zhvillimin e avantazheve të veta konkurruese, si turizmi dhe shërbime të tjera, do të rrisë nevojën për profesionistë në fushën e ekonomisë, në profesionet, si: menaxherë, financierë, kontabilistë apo specialistë turizmi. Ndryshimet në programet mësimore veçanërisht të Edukimit Fizik në sistemin arsimor parauniversitar shikohet si stimulim i këtij profesiioni meqenëse janë rritur orët e mësimit të Edukimit izik nëpër shkolla. Në kuadrin e këtyre ndryshimeve çelja e programeve master “Mësues i artit pamor”, “Mësues muzike” paraqitet si mundësi karriere për të ardhmen e të diplomuarve në këtë program.

Shëndetësia sot në Shqipëri ka një stabilitet më të madh dhe është duke u kushtuar gjithnjë e më shumë vëmendje burimeve njerëzore dhe si pasojë ka nevojë për specialistë të kësaj fushe. Nevojat dhe kërkesat për të siguruar një cilësi të lartë të jetës në punë të punonjësve dhe për të

Referenca

ANYN - Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në. (2020). *Raporë Kombëtar. Rinia në Shqipëri 2020*. Tirana: CRCA/ECPAT Shqipëri.

Cecchi, R. (2021, 06 10). *Albania: Incumbent PM's third term improves the political stability outlook amid an ongoing slow economic recovery*. Tratto il giorno 06 16, 2021 da credendo.com:
<https://credendo.com/it/node/556>

Instat. (2021). *Anketa Tremujore e Forcave të Punës. Tremujori I 2021 - Instituti i Statistikave*. Tirana: Instat.

Instat. (2021). *Popullsia e Shqipërisë*. Tirana: Instat.

World Bank. (2021, 04 07). *Albania: Recent Economic Review*. Tratto il giorno 06 16, 2021 da The World Bank:
<https://www.worldbank.org/en/country/albania/overview#3>

Grupi i punës

Ariana Laçej

Julian Kraja

Mario Çurçija

Rrok Smajlaj